



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova /
Ministry of Internal Affairs*

Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja/ Emergency
Management Agency

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-212 i Punes, Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, si dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.05/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, **Agjencia e Menaxhimit Emergjent shpallë:**

KONKURS

për plotësimin e vendit të punës

I.

Pozita: Zjarrfikës / Vushtrri
Nr. i references: AME-REK-03/17
Numri i vendeve të punës: 1 (një)
Koeficienti/ Paga: 484.61
Orari i punes: I plotë
Vendi: Vushtrrisë
Raporton tek: Komandanti i BZ-së, Zëvendës komandantit, Udhëheqësi i ndërrimit

II.

Pozita: Zjarrfikës / Viti
Nr. i references: AME-REK-04/17
Numri i vendeve të punës: 1 (një)
Koeficienti: 5.5
Orari i punes: I plotë
Vendi: Vitisë
Raporton tek: Komandanti i BZ-së, Zëvendës komandantit, Udhëheqësi i ndërrimit.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Merr pjesë në intervenimet për fikjen e zjarrit dhe intervenime të tjera
2. Kujdeset për pajisje dhe mjetet e përdorura gjatë intervenimit
3. Kujdeset për ruajtjen e pasurisë gjatë intervenimit kur nuk është pronari i pranishëm
4. Rregullisht vijon trajnimet (ushtrimet e caktuara)
5. Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjes dhe mjeteve kolektive dhe personale

6. Kryen dhe respekton të gjitha urdhëresat e udhëheqësit të ndërrimit, komandantit ose zëvendësit, përveç atyre urdhëresave të cilat do të ishin vepër kundërvajtës ose penale
7. I kryen edhe detyrat tjera në lëmin profesional

Shkollimi dhe përvoja e kërkuar

- Diploma e shkollës së mesme (e obligueshme).
- Të jetë nën moshën 30 vjeçare (e obligueshme).
- Të ketë aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarrfikës, **Çertifikata Mjekësorë** (e obligueshme).
- Patent shoferi kategoria "C" (e dëshirueshme ka përparësi)
- Të mos jetë i ndjekur penalisht dëshmi nga Gjykata Kompetente (e obligueshme)
- Se paku një (1) vite përvojë pune (e dëshirueshme).

Kohëzgjatja e emërimit

Konform Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Periudha provuese gjashtë (6) muaj.

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data **07.07.2017** deri me datën **27.07.2017**, në ora 16:00.

Mënyra e aplikimit:

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të AME-së, ose të tërhiqen nga web faqja e AME-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën me. ame.rks-gov.net dhe dorëzohen në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ose nëpërmjet postës elektronike (erton.beka@rks-gov.net) dhe postës, në adresën: Zyra e Burimeve Njerëzore, Rr. Dëshmorët e Gollakut p.n Prishtinë/Hajvali, çdo ditë punë nga ora 08:00 -16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni me Erton Beka, nr. tel. 038-200 19-761. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit për kualifikim, dëshmi mbi përvojën e punës dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkojnë për vendin e punës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, nga personeli i Burimeve Njerëzore. ***Agjencia e Menaxhimit Emergjent ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë***.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për shikim (konfirmim) të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuar do të refuzohen.